



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	18.06.2021
Referenc-ë:	07-353/04-100278/21
Për/ Za/ To:	“Marakli t’kerreve”
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-100278/21 nga “Marakli t’kerreve” me përfaqësues Agan Hajdarhoxha me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 28 dhe 29 Qershor 2021 nga ora 12:00.

Në këtë hapësirë do të jenë rreth 50 super vetura të cilat kanë pronarë ndërkombëtar, e që shumica janë të vendeve të ndryshme të botës.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 28 dhe 29 Qershor 2021 nga ora 12:00 dhe lejohet hyrja e veturave në shesh vetëm të qëndrojnë statikë pa mundësi lëvizje.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike, dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Nuk lejohet vendosja e veturave mbi fontanën para Teatrit;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve ;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.